



URDHRI i INXHINIERI'VE
ENGINEERING ORDER
INXHINIERET E DISIPLINAVE
ENGINEERING DISCIPLINES

STATUTI

PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TE PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PERKATESE

INXHINIERËT E DISIPLINAVE 2023

Gjeodezi, Hidroteknik, Ndërtimi (Profili Ndërtues i Përgjithshëm, Profili Transport, Profili Konstruktör), Mjedis (Profili Trajtim Ujerash, Energji), Mekanike (Profili Konstruksione dhe Mjete Lëvizëse, Energjetik), Ekonomike, Materiale, Tekstil dhe Modë, Elektronike, Telekomunikacioni, Informatike, Elektrike, Mekatronike, Matematike, Fizike, Gjeolog (Profili Xheheror, Hidrogjeologji, Gjeologji Inxhinierike, Profili Gjeofizik, Palontolog, Mikro Palontolog, Shpimi) , Miniere (Profili Ndërtim Shfrytëzim, Markshajder, Pasurimi), Agronomi e Larte, Agromjedisi, Përpunim Druri, Pyjore Mekanike Bujqësore

DEKLARATA

Profesionistet qe janë te pajisur me Titullin ''Inxhinier'', qe kane përfunduar edukimi e larte universitar ne Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar me vendet e tjera, me qellim krijimin e një bashkimi te interesave profesionale, gjithnjë e më të ngushtë midis disiplinave profesionale te tyre, janë të vendosur të ndajnë një të ardhme paqësore, të bazuar në vlerat e përbashkëta, si edhe qëllimisht e veçanërisht për te hartuar mekanizmin e bashkëpunimit institucional midis secilit Urdhër Profesional Përkates, e ne vijim zbatimit te se drejtës se ushtrimit te profesionit, te gjithë secilit ne disiplinat përkatëse.

Të ndërgjegjshëm për trashëgiminë profesionale dhe te drejtave dhe detyrimeve te çdo disipline përkatëse te inxhinierive, se bashku themeluam **URDHRIN E INXHINIERIVE** mbi vlerat e pandashme universale të dinjitetit njerëzor te çdo profesionisti, lirisë se ushtrimit te profesionit, te barazisë dhe solidaritetit ne shërbim te tyre. Te drejtat dhe detyrat e çdo profesionisti janë te bazuara në parimet e sundimit të ligjit dhe rregullave, si edhe vendos individin në qendër të aktiviteteve, duke krijuar mbrojtjen e interesit publik, te sigurisë kombëtare, te shëndetit, si edhe duke krijuar një sipërfaqe prej lirisë ne shërbim dhe te autonomisë profesionale duke respektuar edhe parimin e shqyrtimit te pavarur.

Bashkimi i inxhinierëve ne U -in INXHINIERIVE, kontribuon në ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave të përbashkëta, duke respektuar diversitetin si edhe te Inteligjencës se çdo individi, te çdo Disipline te Inxhinierive dhe te drejtën dhe detyrat e secilit profesion, si dhe identitetet kombëtare dhe organizimin e autoriteteve të tyre publike në nivel kombëtar, rajonal dhe nivelet lokale. Se bashku synojmë dhe kërkojmë të promovojmë një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm ne dhënien e shërbimeve dhe sigurojmë një lëvizje te lirë të Profesionisteve, si edhe veçanërisht te shërbimeve dhe kapitaleve te çdo Profesionisti.

Për këtë qëllim, është e nevojshme për të forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore te çdo Disipline Profesionale me vete, nën dritën e ndryshimeve në shoqëri, progresit shoqëror dhe zhvillimet shkencore dhe teknologjik, duke bërë ato të drejta më të dukshme në një Statut dhe te përfaqësuar nga kjo organizate.

Ky Statut riafirmon, me kujdesin e duhur kompetencat dhe detyrat e Urdhrave Profesional Përkates dhe parimin e subsidiaritetit, të drejtat si ato rezultojnë, në veçanti, nga traditat e Universale e çdo Disipline Profesionale.

Statusi Juridik ,
Juridiksioni dhe Kompetenca,
Rregullimi Ligjor, Përputhja e Aktit te Krijimit me Qëllimin e Ligjit

✓ **Statusi Juridik:**

- Enet Publik Kombëtar i Republikës së Shqipërisë

✓ **Juridiksioni dhe Kompetenca**

- Juridiksioni dhe Kompetencat janë në baze dhe në zbatim të gërme a) pika 2 të nenit 2, pika 1 dhe 2 e nenit 22 të LIGJ Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.
- Në vijim të këtij Akti, profesionistët me kualifikimin profesional të veçantë me titull të prezantuar sa më lartë, të cilët zotërojnë dokumentin zyrtar “Diplomë”, kanë kompetencë, jo vetëm të drejtën ligjore për të kryer një veprimtari konkrete, por edhe detyrim për ta ushtruar këtë veprimtari.

✓ **Rregullimi Ligjor**

- Enti Publik Kombëtar, termi i të cilit është shprehur me ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, ka një normë ligjore që disiplinon mënyrën e tij të funksionimit dhe strukturën përkatëse organizative. Në bazë të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”
- Në vijim të këtij Akti, Institucioni i URDHRIIT TE INXHINIERI’VE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE, do të drejtohet nga “Organi Kolegjial”, në dy nivele, të cilët do të ushtrorjnë veprimtarinë e tyre vendimmarrëse dhe ekzekutive-vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale, në bazë të ligjit nr.8480, date 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, si edhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

✓ Përputhja e Aktit të Krijimit me Qëllimin e Ligjit

- ✓ Në kuadër të përmirësimit dhe forcimit të autoritetit publik, të interesave jetike kombëtare, të shërbimeve, të cilët kryejnë aktivitetin vetë-rregullues dhe që lidhen me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë, të shëndetit, të zhvillimit ekonomik, duke respektuar parimin e krijimtarisë dhe shqyrtimit të pavarur, si edhe të autonomisë së profesionistëve. Ky Akt i Krijimit gjen mbështetje thelbësore në të gjitha Konceptet e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, në vlerat, Interesat, përgjegjësitë, si edhe veçanërisht në Forcimin e Institucioneve Publike, Kombëtare (në Republikën e Shqipërisë).
- ✓ Qëllimi është mbrojtja dhe garantimi i standardeve profesionale të këtyre disiplinave, në mënyrë që shërbimet komplekse të ndërtohen mbi mekanizmin e bashkëpunimit, nëpërmjet Kartës Teknologjike Përkatese, si edhe të bëhen prej profesionistëve të kualifikuar, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara. Ky akt është në përputhje të plotë me përmbajtjen dhe qëllimin e ligjit, në ndihmë të së cilit është edhe ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

PERMBAJTJA

KAPITULLI 1	LIGJSHMËRIA
Neni 1	BAZA LIGJORE
Neni 2	QELLIMI I VEPRIMTARISE
Neni 3	JURIDKSIONI, KOHEZGJATJA, QENDRA E VEPRIMTARISE DHE SIMBOLET.
Neni 4	BUXHETI I URDHËRIT
KAPITULLI 2	PARIMET THEMELORE
Neni 5	Inxhinieret me Edukim Universitar Politeknik
Neni 6	Dinjiteti
Neni 7	E drejta për të shërbyer
Neni 8	E drejta për integritetin e profesionistit
Neni 9	KUSHTET THEMELORE
KAPITULLI 3	LIRITË
Neni 11	E drejta e Ushtrimit të Profesionit
Neni 12	Liria e shprehjes dhe informimit
Neni 13	Liria e Studimeve dhe Shkencave
Neni 14	Mbrojtja e të dhënave personale
Neni 15	E drejta për t'u edukuar
Neni 16	Liria për të zgjedhur një profesion dhe e drejta për t'u angazhuar në punë
KAPITULLI 4	BARAZIA
Neni 17	Barazia para ligjit
Neni 18	Mos diskriminimi
Neni 19	Barazia midis burrave dhe grave
KAPITULLI 5	SOLIDARITETI
Neni 20	E Drejta e Profesionisteve për informim dhe konsultim brenda UP-përkatëse
KAPITULLI 6	TE DEJTAT QYTETARE
Neni 21	E drejta për të votuar dhe për të kandiduar si një kandidat në zgjedhjet, për të qene përfaqësueses dhe drejtuese në çdo urdhër.
KAPITULLI 7	ORGANIZIMI DHE DREJTIMI
Neni 22	ORGANET KRYESORE
Neni 23	ASAMBLEJA KOMBETARE
Neni 24	KRYESIA E ENTI KOMBETAR
KAPITULLI 8	KOMPETENCAT
Neni 25	TE DREJTAT DHE DETYRAT

KAPITULLI 9	DREJTIMI, KALENDARI, PROCESVERBALI DHE KUNDERSHTIME ADMINISTRATIVE
Neni 26	KALENDARI NUNEROR I MBLEDHJEVE
Neni 27	DREJTIMI I MBLEDHJEVE
Neni 28	PROCESVERBALI I MBLEDHJEVE
Neni 29	KUNDERSHTIME ADMINISTRATIVE
KAPITULLI 10	ANKIMI I SHERBIMIT
NENI 30	Kërkesë Ankimore/Ankim
NENI 31	Ankimi
NENI 32	Shqyrtimi
KAPITULLI 11	KAPITALI
Neni 33	PRONESIA E PATJETERSUESHME
KAPITULLI 12	MIRATIMI DHE HYRJA NE FUQI
Neni 34	HYRJA NE FUQI E STATUTI
Neni 35	NDRYSHIMI I STATUTIT
Neni 36	REZULTATI I VOTIMIT

REFERUAR Nenit 30, Kodi Civil RSH-se

*Personi juridik mund të kryejë çdo veprim juridik të lejuar në
ligj, në aktin e krijimit ose në statut.*

Neni 1

BAZA LIGJORE

Akti i Bashkimit të Urdhrit, Aktet e Krijimit të Urdhrave profesional Përkatës dhe Statutet respektive miratuar prej shprehjes së vullnetit të gjithë secilit në Profesionin e tij, gjejnë mbështetjen në Aktin Kryesor të shtetit që është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

✓ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Në mbështetje dhe në zbatim të; pikës 1 të neni 11, neni 15, pikës 1 të neni 49, pikës 4 të neni 57, neni 58, pikës 1 të neni 59, të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”,

si edhe

✓ të ligjit “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar);

si edhe

✓ të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

si edhe

✓ të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”,

si edhe

✓ ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), si edhe të VKM-se nr. 649, datë 14.09.2011 ‘Për përcaktimin e listës së specialisteve dhe në specialisteve apo specialisteve plotësues për profesionet e rregulluara;

si edhe

✓ të ligjit nr. 103/2014 “Për Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

si edhe

✓ të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe të Kërkimeve Shkencore në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”

STATUTI

**PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL ‘INXHINIER’ TË PROFESIONEVE PERKATESE**

si edhe

- ✓ *Directive 2005/36/EC of the European Parliament and of the Council of 7 September 2005 on the recognition of professional qualifications, OJ L 255, 30.9.2005, as amended by Directive 2013/55/EU of the European Parliament and of the Council of 20 November 2013 amending Directive 2005/36/EC on the recognition of professional qualifications and Regulation (EU) No 1024/2012 on administrative cooperation through the Internal Market Information System ('the IMI Regulation') OJ L 354, 28.12.2013*
- ✓ *-Communication from the Commission to the European Parliament, the Council and the European Economic and Social Committee on Evaluating national regulations on access to professions COM (2013)676.*

Gëzimi i këtyre të drejtave nënkupton përgjegjësitë dhe detyrat në lidhje me të drejtën e ushtrimit të profesionit të çdo profesionisti respektivisht të çdo disipline të inxhinierisë përkatëse, për personat e tjerë, për shoqërinë dhe për brezat e ardhshëm.

Neni 2

QELLIMI I VEPRIMITARISE

Qellim është koordinimin dhe garantimin e vetë rregullimit të të drejtës së ushtrimit të profesioneve specifike, si edhe detyrimin për të menaxhuar zhvillimin e qëndrueshmërinë të;

1. Inteligjencës Profesionale të Disiplinave të Inxhinierive si edhe të nën disiplinave, por pa u kufizuar tek specialistet dhe nën specialistet plotësues.
 - Mbështetur në kapaciteti intelektual i njerëzve që kryejnë shërbime profesionale, të cilët karakterizohen nga perceptimi, vetëdija dhe vullneti i tyre për ushtruar profesionin.
 - Mbështetur në inteligjencën e profesionistit me nivelin e lartë të edukimit që posedojnë aftësitë njohëse për të mësuar, për të formuar koncepte, për të kuptuar, për të aplikuar logjikën dhe arsyen, duke përfshirë kapacitetin për të njohur modelet e kodit të vetë rregullimit, dhe që kuptojnë idetë, planifikojnë, zgjidhin probleme, marrin vendime, mbajnë mend, se edhe të përdorin gjuhën për të komunikuar.
2. Koordinimit të Punës ndërmjet urdhrave të veçantë, më qëllim që të garantohet vetë rregullimi dhe funksionimi i secilit Urdhër, si edhe do të angazhohet për të nxitur dhe krijuar urdhrat e veçanta, si edhe do të ndihmojë për hartimin e Akteve Administrative, etj.;
3. Administrimit të mirë;
 - Çdo profesionist ka të drejtë të ketë çështjet e tij apo të saj të cilat do të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme nga institucionet e urdhrave profesional përkatës dhe trupat e Enti Kombëtar. Kjo e drejtë përfshin:
 - a) Të drejtën e çdo profesionist për t'u dëgjuar, para çdo masë individuale e cila do të ndikojë në atë çka mund të jetë marrë negativisht;

- b) Të drejtën e çdo profesionisti që të ketë qasje në dosjen e tij apo të saj, duke respektuar interesat legjitime të konfidencialitetit, sekretit profesional dhe të biznesit;
- Detyrimi i administratës për të dhënë arsyet për vendimet e saj.
- 4. Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shërbimeve në fushat e Disiplinave të Inxhinierisë;
 - Përcaktimit të hapësirës së shërbimeve të Disiplinave të Inxhinierive, mbi Kualifikimin e përfutur nga Edukimi i Nivelit të Lartë.
 - Ndërtimin e Hapësirës së Inteligjencës Profesionale të Disiplinave të Inxhinierive me qëllim të interpretimit dhe përcaktimit të Titullit Inxhinier, për çdo disiplinë dhe për të unifikuar në të ardhmen drejt integritetit ndërkombëtar të shoqërisë. Hapësirës së Inteligjencës Profesionale të Disiplinave të Inxhinierive, veçanërisht nënkupton ndarjen e Termi të Titullit "Inxhinieri" aktiviteti i cili ushtrohet në;
 - a) Sipërfaqen e Zhvillimit dhe Prodhimit Ekonomik,
 - b) Detyrë/Detyrim në Inxhinieri të Specifikuar,
 - c) Detyrim i veçantë i Inxhinierisë i apo jo i domosdoshëm.

Neni 3

JURIDKSIONI, KOHEZGJATJA, QENDRA E VEPRIMTARISE DHE SIMBOLET.

Në mbështetje të neneve 24, 25, 26, (përmbajtja e personit juridik), të nenit 27, (emri i personit juridik), të nenit 28, (qendra e personit juridik), të nenit 29,30,31, (zotësia e personit juridik), të "Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë"

- 1) Urdhri i Inxhinierive në Republikën e Shqipërisë është Person Juridik, është Ent Kombëtar që përfaqëson interesat e përbashkëta, të profesionistëve me kualifikimin profesional me Edukim të Lartë Universitar, të cilët zotërojnë dokumentin zyrtar "Diplomë" dhe që vetë-rregullohen, i njohur edhe nga *ligji nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë"* (i ndryshuar).
- 2) Personi Juridik ka emrin e tij të plotë dhe të shkurtuar. Emri i Entit Kombëtar do të quhet "Urdhri i Inxhinierive në Republikën e Shqipërisë", (UIRSH-së), si edhe do të ketë stemën dhe vulën autentike, që do të jetë stema e Republikës së Shqipërisë. Në çdo akt administrativ në krye të fletës do të vendoset edhe identiteti dhe pozicion gjeografik Evropian me flamur, si edhe identiteti i Shtetit me flamur, siç është vendosur në krye të këtij akti (*referuar ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, "Për Formën dhe Përmasat e Flamurit Kombëtar, Përmbajtja e Himnit Kombëtar, Formën dhe Përmasat e Stemës së Republikës të Shqipërisë dhe Mënyrën e Përdorimit të Tyre"* i ndryshuar).
- 3) Qendra e "Urdhri i Inxhinierive në Republikën e Shqipërisë" (UIRSH-së), do të jetë në Tiranë, ku do të jenë dhe organi drejtues edhe ekzekutiv i tij.
- 4) Zotësia e personit juridik e (UIRSH-së), do të fitojë të drejtat dhe do të marrë përsipër detyrime civile që nga çasti i këtij Akt-Krijimit, si edhe jetëgjatësia është PA AFAT.
- 5) (UIRSH-së), mund të kryejë çdo veprim juridik të lejuar në ligj, në aktin e krijimit, si edhe vepron me anë të organeve të veta të parashikuara, në këtë akt krijimi, në kete statut.

STATUTI

PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PERKATESE

Neni 4

Buxheti i Urdhrit

- 1) Urdhri i Inxhinierive është ent publik jo buxhetor, ai ka buxhetin e tij, të cilin e miraton Asambleja Kombëtare dhe e administron Kryesia në përputhje me rregullat financiare në fuqi dhe me rregulloren e brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit, të miratuar nga kjo asamble.
- 2) Burimet financiare të Urdhrit të Inxhinierive janë të ardhurat nga:
 - a) të cilat përcaktohen me vendim të Urdhrit;
 - b) tarifat e vendosura për aktet dhe dokumentet e lëshuara nga Urdhri;
 - c) tarifat e shërbimeve;
 - d) grande, donacione të ndryshme vendase dhe të huaja të ligjshme;
 - e) aplikimet për projekte administrimi edukimi trajnimi etj. të kësaj natyre, dhuratat, subvencionet e sponsorizimet, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe të ardhura të tjera të ligjshme.
- 3) Të ardhurat e siguruara, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2, të këtij neni, Urdhri i përdor për të përmbushur synimet dhe objektivat e tij.

KAPITULLI 2

PARIMET THEMELORE

Neni 5

Inxhinieret me Edukim Universitar

Inxhinierët me Edukim të Lartë Universitar mbështesin dhe avancojnë integritetin, nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre nëpërmjet:

-  Përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre për rritjen e mirëqenies njerëzore në mjedisit dhe të natyrës;
-  Sinqeritetit dhe të paanshmërisë duke shërbyer me besnikëri kundrejt publikut, punëdhënësve dhe klientëve të tyre;
-  Përpjekjeve për të rritur kompetencën dhe prestigjin e profesionit të disiplinave përkatëse;
-  Mbështetjes së shoqërive profesionale dhe teknike të disiplinave të tyre.

Neni 6

Dinjiteti

Dinjiteti i një profesionisti është i pacënueshëm. Ai duhet të respektohet dhe të mbrohet. Dinjiteti është tërësia e vlerave morale të njeriut a të një grupi njerëzish (nderi, krenaria etj.); vetëdija që ka njeriu a një grup njerëzish për këto vlera e për të drejtat e veta në shoqëri dhe nderimi i tij për vetveten. Cilësia e mirë a vlera e lartë e diçkaje që e bën atë të çmohet. Me dinjitet profesional.

STATUTI
PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PERKATESE

Neni 7

E drejta për të shërbyer

Gjithkush ka të drejtën për të dhënë shërbimin e tij, duke respektuar te drejtat dhe detyrimet e çdo Disipline Profesionale.

Asnjë Profesionist nuk mund të paralizohet dhe të privohet nga e drejta e kryerjes së një shërbimi, nëse për atë nuk ka prova bindëse dhe të qarta për të cilin e bën të pamundur aftësinë e tij.

Neni 49 i Kushtetutës së RSH

1). Secili ka të drejtën të fitoj mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vete. Ai është i lire të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vete profesional

Neni 8

E drejta për integritetin e profesionistit

Gjithkush ka të drejtën e respektimit të integritetit për çdo profesionist. Integriteti në ushtrimin e profesionit, do të përshkojë çdo aspekt të punës, nga mënyra sesi merreni me klientët tuaj, deri në mënyrën se si i trajtoni bashkëpunëtorët dhe eprorët tuaj. Do të thotë të bësh gjërat e duhura, në çdo kohë edhe nëse askush nuk po i shikon, aq më pak drejtuesi apo institucioni përfaqësueses i juaj. Ndikimi i saj më i madh shihet në marrëdhëniet tuaja me njerëzit përreth jush, kjo është arsyeja pse integriteti shihet si një nga përbërësit më të rëndësishëm të Besimit. Çdo profesionist mund të fitoj një nivel të caktuar besimi nëse është në gjendje të arrini rezultate ndërsa demonstroi shqetësim për të tjerët dhe veproni me integritet gjatë gjithë kohës.

Neni 9

KUSHTET THEMELORE

- 1) Profesionisti do të mbajnë parësore vlerën e sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së publikut dhe do të përpiqen të zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale.
- 2) Profesionistet kryejnë shërbime vetëm në fushat e kompetencave dhe aftësive të përfituara të certifikuara të tyre.
- 3) Profesionisti do të lëshojnë deklarata publike vetëm në një mënyrë objektive dhe të vërtetë.
- 4) Profesionisti duhet të veprojnë në çështjet profesionale për secilin punëdhënës ose klient si agjentë ose besimtarë besnikë dhe duhet të parandalojë dhe të shmangë konfliktin e interesave.
- 5) Profesionisti do të ndërtojnë reputacionin e tyre profesional në bazë të meritës së shërbimeve të tyre dhe nuk do të konkurrojnë padrejtësisht me të tjerët.

- 6) Profesionisti do të veprojnë në atë mënyrë që të mbështesin dhe rrisin nderin, integritetin dhe dinjitetin e profesionit të inxhinierisë së disiplinës përkatëse dhe do të veprojnë me tolerancë zero për ryshfet, mashtrim dhe korrupsion.
- 7) Profesionisti do të vazhdojnë zhvillimin profesional në karrierën e tyre dhe do të sigurojnë mundësi për zhvillimin profesional për Ato/Ata inxhinierë që kanë nën mbikëqyrje, duke nxitur edhe barazinë gjinore në ushtrimin e profesionit në veprimtarinë e disiplinës përkatëse.
- 8) Profesionisti nuk duhet të nxisin, urrejtje kundrejt inxhinierëve të tjerë dhe institucioneve përfaqësues.

KAPITULLI 3

LIRITË

Neni 11

E drejta e Ushtrimit të Profesionit

Çdo profesionist ka të drejtën për të ushtruar profesionin e rregulluar të përfutur prej tij vetëm kur regjistrohet në Urdhrin Profesional të Disiplinës Përkatëse.

Neni 12

Liria e shprehjes dhe informimit

Gjithkush prej profesionistëve ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe për të marrë dhe dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e urdhrave profesional dhe autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë.

Neni 13

Liria e Studimeve dhe Shkencave

Kërkimet Shkencore dhe Krijimi i Studimeve do të jenë pa detyrim. Liria akademike dhe e shërbimeve profesionale do të respektohet.

Neni 58 i Kushtetutës së RSH

1). Liria e krijimit artistik dhe e kërkimeve shkencore, vënia në përdorim, si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë.

Neni 14

Mbrojtja e të dhënave personale

Gjithkush ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale që i përkasin çdo Profesionist.

Të dhënat e tilla duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të drejtë për qëllimet e specifikuar dhe në bazë të pëlqimit të personit në fjalë apo në një tjetër bazë legjitime të parashikuar nga ligji. Gjithkush ka të drejtën e aksesit në të dhënat e mbledhura që i përkasin dhe të drejtën për të korrigjuar.

STATUTI

PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVË
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PËRKATËSE

Përputhshmëria me këto rregulla do të jetë në lidhje me kontrollin nga Urdhri Profesional i Disiplinës përkatës.

Neni 15

E drejta për t'u edukuar

Gjithkush nga Profesionistet ka të drejtën për t'u edukuar dhe për të patur akses në trajnim profesional dhe të vazhdueshëm. Kjo e drejtë përfshin mundësinë për të marrë edukim të detyrueshëm, nga çdo Urdhër Profesional të Disiplinave përkatëse, por edhe për ato edukime që bashkërisht Urdhërat kanë rënë dakord paraprakisht.

Neni 16

Liria për të zgjedhur një profesion dhe e drejta për t'u angazhuar në punë

Gjithkush ka të drejtë për t'u angazhuar në punë dhe të ndjekë një profesion të zgjedhur lirisht apo të pranuar. Çdo profesionist ka lirinë për të kërkuar punësim, për të punuar, për të ushtruar të drejtën e profesionit dhe vendosjes edhe për të ofruar shërbime. Profesionistet e vendeve të tjera të cilët mund të punojnë në Shqipëri kanë të drejtë të ekuivalentojnë kurikulën.

KAPITULLI 4

BARAZIA

Neni 17

Barazia para ligjit

Gjithkush është i barabartë para ligjit.

Neni 18

Mos diskriminimi

Çdo diskriminim i bazuar në çfarëdo fushe të disiplinës profesionale përkatëse për shkak të profesionit të gjithsecilit, apo pa aftësisë për të ushtruar profesionin, si edhe seksi, raca, ngjyra, origjina etnike ose sociale, karakteristika gjenetike, gjuha, feja apo besimi, opinionin politik ose çdo opinion tjetër, anëtarësia e pakicave kombëtare, pronës, lindjes, paaftësisë, moshës apo orientimit seksual ndalohen.

Neni 19

Barazia midis burrave dhe grave

Barazia ndërmjet burrave dhe grave duhet të sigurohet në të gjitha fushat e disiplinave të inxhinierive përkatëse, duke përfshirë përfaqësimin në çdo urdhër profesional përkatës sipas legjislacionit në fuqi.

Parimi i barazisë nuk do të ndalojë mbajtjen ose miratimin e masave që sigurojnë avantazhe të veçanta në favor të gjinisë më pak të përfaqësuar.

STATUTI

PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PËRKATËSE

Neni 20**E Drejta e Profesionisteve për informim dhe konsultim brenda UP-përkatëse**

Profesionistet duhet, në nivelet e duhura, t'ju garantohet informacioni dhe konsultimi në kohë të mira në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara në ligjin për organizimin dhe funksionin e urdhrit përkatës, statuteve apo rregulloreve përkatëse dhe praktikave ndërkombëtare dhe kombëtarë.

Neni 21**E drejta për të votuar dhe për të kandiduar si një kandidat në zgjedhjet, për te qene përfaqësueses dhe drejtuese ne çdo urdhër.**

Çdo Inxhinier i regjistruar ne Urdhrin Profesional te Disiplinës Përkatëse, ka të drejtën për të votuar dhe për të kandiduar si një kandidat në zgjedhjet për organet funksionale dhe drejtuese, në Urdhrin Profesional në të cilin ai ose ajo është anëtarë.

Çdo kandidat, për te qene anëtar ne institucionin përfaqësues dhe drejtues, do të zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë universal në një votim të lirë dhe të fshehtë dhe do te përfaqësojnë, për 1 (një) periudhë zgjedhore, me te drejte për te mare pjese maksimalisht te paktën edhe për një periudhë vijues.

Neni 22**ORGANET KRYESORE**

Enti Kombëtar, drejtohet nga organet përfaqësuese, të cilat do të ushtrojnë veprimtarinë vendimmarrëse dhe ekzekutive në mënyrë kolegjiale, *në zbatim të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”.*

- 1) Organet kryesore vendimmarrëse, të Entit Kombëtar janë:
 - a) Asambleja Kombëtare;

STATUTI
PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TE PROFESIONISTEVE
ME TITULL ‘INXHINIER’ te PROFESIONEVE PERKATESE

- b) Këshilli i Presidentëve;
- c) Kryesia e Entit Kombëtar;
- 2) Enti Kombëtar, do të ketë strukturën ekzekutive në përbërje, si:
 - a) Sekretari i Përgjithshëm (administratori i entit);
 - b) Zyra e Strategjisë dhe Menaxhimit të Riskut;
 - c) Zyra e Koordinimit Kombëtar;
 - d) Zyra e Koordinimit Ndërkombëtar;
 - e) Zyra e Informimit dhe Konsultimit Publik;
- 3) Enti Kombëtar përfshin edhe disa struktura të ngritura në përbërje ose pranë tij, si:
 - a) Regjistra Kombëtar që përfshijnë shërbime komplekse të inxhinierive;
 - b) Arkiva Administrimi dhe Ekzekutimi;
 - c) Baza të dhënash Kombëtare dhe Ndërkombëtare;
 - d) Fjalori Teknik Universal dhe Biblioteka.

Neni 23

ASAMBLEJA KOMBETARE

- 1) Asambleja Kombëtare është organi më i lartë përfaqësues i Entit Kombëtar.
- 2) Asambleja Kombëtare është organ vendimmarrës përbëhet nga tërësia e anëtarëve si me poshtë:
 - a) Nga Presidentet e çdo Enti Kombëtar të disiplinave përkatëse të Inxhinierisë;
 - b) Anëtarët themelues të Entit Kombëtar;
 - c) Anëtarët themelues të çdo Enti Kombëtar të disiplinës përkatëse të Inxhinierisë;
 - d) Anëtarët e Kryesisë së Entit Kombëtar të Urdhrit të Inxhinierive.
 - e) Anëtarët e Kryesisë së çdo Enti Kombëtar të disiplinave përkatëse; Përkatësisht të 5 anëtarët, Presidenti, zëvendës Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtuesi i Edukimit, Drejtuesi i Komisionit Disiplinor dhe Etikes, pamvarsisht nga përzgjedhje e drejtuesve të rijnë të Kryesive këta (ish) do të jenë gjithmonë anëtarë të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Inxhinierive;
- 3) Pozicionin e Presidentit do ta përfaqësojë anëtari themelues i U-it të Inxhinierive deri në Konstituimin dhe zgjedhjen e Presidentit të Urdhrit përkatës.
- 4) Në rastin që përfaqësimi nuk behet i mundur nga themeluesi (i disiplinës përkatëse dhe ose të pa përfaqësuarit), me krijimin e Entit Kombëtar të disiplinës së inxhinierit përkatëse pozicioni i Presidentit do ta përfaqësojë Kryetari i Urdhrit Përkatës.
- 5) Mbledhja e Asamblesë Kombëtare thirret nga Sekretari i Përgjithshëm dhe ose kur kërkohet nga 1/3 e të gjithë anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.
- 6) Asambleja Kombëtare do të funksionojë me dy dhoma.
 - 1. Nga Kolegji i Presidentëve, (1).
 - 2. Nga të gjithë tërësia e Anëtarëve, (1,2,3,4).
- 7) Asambleja Kombëtare ka këto funksione:

STATUTI

PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PËRKATESE

A. DHOMA 1- Kolegji i Presidenteve, (1).

- a) Miraton rregulloren (KODIN), që garantohet vetë rregullimin dhe funksionimin;
 - b) Miraton skemat përkatëse të menaxhimit të shërbimeve komplekse inxhinierike;
 - c) Miraton aktivitet ekonomike (shërbimet) në varësi të këtij Entit;
 - d) Propozon Planin e Strategjisë dhe Menaxhimit të Riskut;
 - e) Propozon ndryshimet në Statut, Rregulloret, etj.
 - f) Është Përgjegjës për konfirmimi përfundimtar për "konsultimin me publikun", për njoftimin publik të shoqërisë, si edhe për konsultimi teknik me çdo urdhër përkatës.
 - g) Kolegji i Presidenteve merr në shqyrtim dhe vendos për ato çështje të karakterit teknik, që përkon me koordinimi të shërbimeve komplekse, por jo në themel të shërbimit teknik specifik.
 - h) Kolegji si rregull mbledhet 1 herë në muaj. Drejtimi i tij bëhet me rotacion nga çdo presidencë e urdhërve përkatës, radha e tij formohet si rezultat i kohës së krijimit të çdo urdhri përkatës.
 - i) Kolegji i Presidenteve vendosin me konsensus dhe me unanimitet për çdo çështje, në rast se nuk arrihet, konsensusi në dy takime, atëherë do të hidhet në votim me të gjithë tërësinë e Anëtarëve të asamblesë, (1,2,3,4) që është dhoma 2.
 - j) Në zbatim të germës i), të këtij neni; Kolegji i Presidenteve mund të organizohet në grupe sipas ndarjes së Termit të Titullit "Inxhinieri", sa më sipër;
 - a) Sipërfaqen e Zhvillimit dhe Prodhimit Ekonomik,
 - b) Detyrë/Detyrim në Inxhinieri të Specifikuar,
 - c) Detyrim i veçantë i Inxhinierisë i apo jo i domosdoshëm.
- Me rast se konsensus dhe me unanimitet gjendet edhe brenda çdo grupi për çështjet që përkojnë atij grupit, atëherë edhe ky fakt konsiderohet konsensus unanim.

B. DHOMA 2 - Tërësia e Anëtarëve të Asamblesë, (1,2,3,4).

- a) Zgjedh Kryesin e Entit Kombëtar me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj, për një periudhë 5 (pese) vjeçare.
- b) Ky proces përzgjedh (*young leaders*) drejtuesit e rinj të Kryesisë jo më vonë se 12 muaj para përfundimit të mandatit të kryesisë, d.m.th. do të kryhet në vitin e katërt që përkon me mbylljen e së drejtës së qeverisjes së Kryesisë së mëparshme. Data efektive 5 vjeçare është data e aktit të krijimit.
- c) Miraton Planin e Strategjisë dhe Menaxhimit të Riskut;
- d) Miraton Statutin e Urdhrit;
- e) Miraton rregullore për organizimin dhe funksionimin e Asamblesë Kombëtare;
- f) Miraton rregullore për administrimin dhe funksionimin e entit;
- g) Analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit, Shqyrton raportin e auditit të jashtëm, sipas përcaktimit, si edhe miraton Buxhetin.

Neni 24

KRYESIA E ENTI KOMBETAR

1) Kryesia është organ vendimmarrës-ekzekutiv administrativ i Entit Kombëtar.

Kryesia përbëhet nga 5 pese Anëtarë:

- a) Sekretari i Përgjithshëm (administratori i entit);
 - b) Drejtuesi i Zyrës se Strategjisë dhe Menaxhimit të Riskut (sek 2);
 - c) Drejtuesi i Zyrës se Koordinimit Kombëtar, (sek 3);
 - d) Drejtuesi i Zyrës se Koordinimit Ndërkombëtar, (sek 4);
 - e) Drejtuesi i Zyrës se Informimit dhe Konsultimit Publik, (sek 5);
- 2) Kryesia e Urdhrit organizon dhe drejton Urdhrin në bazë e në zbatim të aktit të krijimit, statutit të tij dhe vendimeve të Asamblesë Kombëtare.
- 3) Kryesia e Urdhrit zbaton të drejtat e ngarkuara me ligj, akteve nënligjore, si edhe ligjeve të tjera të Republikës së Shqipërisë.
- 4) Kryesia e Urdhrit është përgjegjës:
- a) për organizimin dhe drejton punën në administratën e Urdhrit;
 - b) për ndjekjen e vazhdueshme të zbatimit të vendimeve të Asamblesë Kombëtare;
 - c) për harmonizimin, bashkërendimin e punës, monitorimin dhe ofrimin e asistencës teknike;
 - d) përgatit rregulloren për organizimin e zgjedhjeve të përgjithshme të entit;
 - e) përgatit Statutin dhe rregulloret e Urdhrit;
 - f) si edhe akteve të tjera për vendimmarrje;
- 5) Kryesia ka të drejtën e personit juridik për:
- a) Lidhjen e kontratave;
 - b) E padive administrative, civile dhe penale;
 - c) E mbajtjes së llogarive;
 - d) Të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

KAPITULLI 8

KOMPETENCAT

Neni 25

TE DREJTAT DHE DETYRAT

Të drejtat dhe detyrat janë si më poshtë këtij Akt Krijimi, por pa u kushtëzuar në legjislacionin në fuqi që mund të lejojë kryerjen e veprimeve gjithmonë në të mirë, si edhe në interes të Institucioni dhe Shoqërisë.

Të drejtat dhe detyrimet e Urdhrit të Inxhinierive.

Në bazë dhe zbatim të së drejtës së ushtrimit të profesionit të të gjithë secilit dhe bashkërisht për ato shërbime që mekanizmi i bashkëpunimit është i domosdoshëm ushtron këto të drejta:

STATUTI
PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL ‘INXHINIER’ të PROFESIONEVE PERKATESE

- 1) E drejta e vetë rregullimit:
 - a) vendos dhe miraton rregulloren (KODIN), që garantohet vetë rregullimi dhe funksionimi i institucioneve, mbi këtë kusht apo koncept, si edhe do të angazhohet për të nxitur dhe zbatuar dhe krijuar urdhrat e veçanta, si edhe do të ndihmojë për hartimin e Akteve Administrative, Unike, etj.;
 - b) miraton regjistrin kombëtar të shërbimeve për çdo disiplinë.
 - c) nxjerr vendime, urdhra dhe udhëzime Administrative (jo teknike), që janë të detyrueshme për zbatimin e një shërbimi kompleks, të skemës përkatëse të menaxhimit dhe bashkëpunimit të shërbimit duke përcaktuar qarte detyrat dhe përgjegjësitë e çdo disipline profesionale (jo teknike'' për krijimin e akteve teknike është detyrë e çdo urdhri profesional);
 - d) krijon struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave;
- 2) Te ndërtojë hapësirën e Inteligjencës Profesionale të Disiplinave të Inxhinierive me qëllim të interpretimit dhe përcaktimit të Titullit Inxhinier, për çdo disiplinë dhe për të unifikuar në të ardhmen drejt integritetit ndërkombëtar.
- 3) Të promovojë, botojë dhe shpërndajë standardet e reja ndërkombëtare, si dhe të garantojë respektimin e tyre në shërbim të shoqërisë.
- 4) Te ndërtoj fjalorin Teknik Universal për të gjitha disiplinat e inxhinierive, si edhe interpretimi për çdo tog fjalësh apo fjali që përdoret për çdo çështje në fushat e disiplinave përkatëse.
- 5) Vendos për të drejtën e administrimit me të mirë. Me qëllim parandalimi për çdo masë individuale e cila do të ndikojë në atë çka mund të jetë marrë negativisht për shoqërinë e inxhinierëve. Urdhri i Inxhinierive përcakton hapësirën e përgjegjësisë profesionale për çështje;
 - a) të hetimit dhe gjykit, administrativ;
 - b) të hetimit dhe gjykit, administrativ - civil;
 - c) të hetimit dhe gjykit, civil;
 - d) të hetimit dhe gjykit, civil - penal;
 - e) të hetimit dhe gjykit, penal;
- 6) E drejta e pronësisë:
 - a) ushtron të drejtën e pronësisë që e fiton, shet dhe jep në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të tij, si dhe ushtron të drejtat të tjera sipas legjislacionit në fuqi për çështjet e pronësisë;
 - b) të drejta e pronësisë ushtrohet nga Asambleja Kombëtare (dhoma 2) e Urdhrit, i cili nuk mund t'ia delegojë ushtrimin e kësaj të drejte askujt tjetër.
- 7) E drejta e kryerjes së veprimtarive ekonomike:
 - a) ushtron të drejtën e veprimtarisë ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit, si edhe të çdo disipline përkatëse të Inxhinierive, nëpërmjet krijimit të njësive ekonomike e institucione në varësi të tij, (për shërbime komplekse të inxhinierive);
 - b) ushtron të drejtën e përdorimit të të ardhurave që përfitohen nga veprimtaria ekonomike për mbështetjen dhe përmbushjen e funksioneve të Entit Kombëtar.

- 8) E drejta e personit juridik, gëzon dhe ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi:
- a) të drejtën e lidhjes së kontratës;
 - b) të drejtën e krijimit të personave të tjerë juridikë;
 - c) të drejtën e ngritjes së padisë administrative, civile dhe penale;
 - d) të drejtën e mbajtjes së llogarive;
 - e) të drejta të tjera për ushtrimin e funksioneve në bazë dhe në zbatim të ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

KAPITULLI 9

DREJTIMI, KALENDARI, PROCESVERBALI DHE KUNDERSHTIME ADMINISTRATIVE

Neni 26

KALENDARI NUNEROR I MBLEDHJEVE

- 1) Urdhri i Inxhinierëve në ushtrimin e së drejtës publike, për veprimtarinë ekzekutive vendimmarrëse në mënyrë kolegjiale është e detyrueshme të zbatohet grafiku minimal i mbledhjeve. Në këtë Akt Vendoset grafiku minimal si më poshtë:
 - a) Asambleja Kombëtare
 - ✓ DHOMA 1 - Kolegji i Presidentëve (1), mbledhet minimalisht 1 herë në muaj;
 - ✓ DHOMA 2 - Tërësia e Anëtarëve të Asamblesë, (1,2,3,4), mbledhet minimalisht 2 herë në vit;
 - b) Kryesia mbledhet minimalisht 1 herë në javë;
- 2) Mbledhjet e Paneleve Teknike bëhen në përputhje me programin dhe miratuar nga Asambleja Kombëtare, Kolegji i Presidentëve dhoma 1.
- 3) Mbledhjet e Kryesisë bëhen me thirrje nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 27

DREJTIMI I MBLEDHJEVE

DHOMA 1 - Kolegji i Presidentëve (1), përbehet nga Presidentet e Urdhrave Profesional përkatës, të cilët janë njëkohësisht edhe Drejtuesit e Asamblesë së DHOMES 1, të Urdhrit të Inxhinierëve.

- 1) Presidenti/Drejtues, drejton mbledhjen, drejton diskutimet dhe siguron zbatimin e ligjit dhe marrjen e vendimeve të drejta.
- 2) Presidenti/Drejtues mund të shtyjë ose të mbyllë mbledhjen përpara kohe, në rastet kur situata e përligj këtë veprim. Në këto raste duhet të merret një vendim i arsyetuar, i cili do të pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes.
- 3) Çdo president do të drejtojë këtë asamble sipas radhës, që përkon me kohën e themelimit të çdo Urdhri Përkatës.

- 4) Koha e drejtimit të një Presidence do të jetë për një periudhë 1 muaj. Nëse Presidenca sipas radhës heq dorë nga drejtimi, drejtimi e merr Presidenca vijuese.
- 5) DHOMA 2 - Tërësia e Anëtarëve të Asamblesë, (1,2,3,4), Organizimin dhe Drejtimi e mbledhjes do ta kryej Kryesia e Urdhrit nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm.
- 6) Funksionimi bëhet sipas këtij Akti dhe rregullores së miratuar nga Asambleja Kombëtare.

Neni 28

PROCESVERBALI I MBLEDHJEVE

- 1) Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e gjithçkës që, u tha në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
- 2) Procesverbal mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbal nënshkruhet së bashku nga Drejtuesi i Seance dhe Sekretari.
- 3) Në rastet kur votë organi e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbal miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.
- 4) Vendimet jo normative të organeve kolegjiale hyjnë në fuqi vetëm pasi të jetë miratuar procesverbal përkatës.
- 5) Vendimet të cilat merren nga Asambleja Kombëtare për ato vendime që konsiderohen të cilësuar, do të bëhen gjithmonë me nënshkrim procesverbal (PROCESVERBAL NËNShkrimi).

Neni 29

KUNDERSHTIME ADMINISTRATIVE

Drejtuesit ose çdo anëtar tjetër i organit kolegjial, Asamblesë Kombëtare dhe Kryesisë, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatën administrative kundër vendimeve të marra nga këto organe dhe të kërkojë pezullimin e zbatimit të tij, kur çmon se vendimi është i kundërligjshëm.

KAPITULLI 10

ANKIM I SHËRBIMIT

NENI 30

Kërkesë Ankimore/Ankim

1. Kërkesat për ankim të shërbimit profesional të karakterit teknik në fushën e Shërbimit të paracaktuar nga urdhri i Inxhinierëve, lidhur me Karakterin e Strukturës së Shërbimit Kompleks si edhe të atyre shërbimeve që kryen nga me shumë se një profesionit të një profesioni i drejtohen Urdhrit të Inxhinierëve.
2. Kërkesa për Ankim të Shërbimit mund të paraqiten nga:

STATUTI
PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PËRKATESE

- a) çdo person fizik apo juridik që përfiton shërbimin dhe/ose eksperti që kryen shërbimin;
 - b) organet Drejtuese të Urdhrit të Inxhinierive;
 - c) çdo organ tjetër shtetëror, ent, universitet, prokurori, gjykatë, etj. të parashikuar me ligj;
3. Personat mund të kërkojnë:
- a) të kthehet për rivlerësim dhe korrigjim të të metave;
 - b) të kryhet tërësisht shërbimi nga e para;
 - c) të kryhet shërbimi nga Urdhri.
4. Nëse palët nuk arrijnë të sigurojnë ose nuk paraqesin dokumentacionin e plotë për rrethana të justifikuara ose të pajustificuara Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional vendos të kryhet shërbimi nga Urdhri, dhe nëse ka element që çojnë në një vepër penale bën kallëzim në organet kompetente.
5. Nëse aktet e hartuar nga eksperti që nuk janë të ankimuara nga palët sipas pikës 2, të këtij neni dhe që nuk janë zbatuar, eksperti dhe/ose palët përfituese kanë të drejtë të dërgojnë kërkesën për konfirmim të Aktit brenda një periudhe kohore deri në 15 ditë pune nga koha e njoftimit të Aktit.

NENI 31

Ankimi

- 1 Personi fizik apo juridik paraqet kërkesën ankimore/ankimin lidhur me shërbimin e kryer pranë Urdhrit, kur personi fizik/juridik që ka kryer shërbimin ka vepruar në kundërshtim me normat teknike dhe referencat profesionale me Karakterin e strukturës së shërbimit Kompleks, në kryerjen e shërbimit, që rregullojnë fushën e shërbimit përkatës profesional të miratuar nga Urdhri i Inxhinierive, si edhe në legjislacionin tatimor.
- 2 Eksperti i cili ka kryer shërbimin, mund të ankohet pranë Urdhrit lidhur me mos zbatimin e këtij ligji nga personi fizik/juridik që ka kryer shërbimin.

NENI 32

Shqyrtimi

1. Për shqyrtimin e kërkesave për Ankimim të shërbimit, pranë Urdhrit funksionon Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, si organizëm i gjykimit profesional. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë të miratuar nga Asambleja Kombëtare, me mandatë të hapur, përkatësisht:
- a) një përfaqësues nga Asambleja Kombëtare;
 - b) një nga Kryesia e Urdhrit;
 - c) një nga stafi i Urdhrit;
 - ç) dy inxhinierë nga jashtë administratës së Urdhrit (përkatësisht të profilit përkatës që përkon me Titullin e Ekspertit);
 - d) Kryetari i Komisioni të Ankimit të Shërbimit Profesional zgjidhet me short për çdo çështje ankimi nga përbërja e komisionit.
2. Mënyra e ngritjes dhe funksionimit të Komisioni të Ankimit të Shërbimit Profesional

STATUTI
PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TË PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' të PROFESIONEVE PERKATESE

përcaktohet në rregulloren e gjykimit profesional të Urdhrit.

3. Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Rregullave të Miratuar nga Urdhri i Inxhinierëve për ato shërbime të parashikuar dhe pa diktuar në shërbimet unike të secilës Disipline.

4. Detyra kryesore e Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional, në përmbushje të objektit të punës së tij lidhur me shqyrtimin e ankesës ndaj shërbimit të bërë sipas të këtij akti dhe të rregullores, është të kontrolloj:

- a) përputhshmërinë me detyrën;
- b) rregullshmërinë e kushteve strukturale dhe teknike;
- c) ligjshmërinë për zhvillimin e qëndrueshëm të projektit;
- ç) sigurinë, shëndetin dhe interesin publik.

5. Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, me ekspertizë të Urdhrit ose të pavarur, mund të organizojë anketime të publikut për problemet e respektimit të Këtyre rregullave për kryerjen e shërbimit. Përfundimet që nxjerr nga studimi i anketimeve dhe nga ankesat e publikut ia raporton Urdhrit, duke sugjeruar masat për përmirësim.

6. Çdo 6 muaj Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, boton një përmbledhje të përfundimeve të nxjerra, në bazë të këtij neni, në një buletin të veçantë që botohet nga Urdhri.

7. Procedura administrative fillon me paraqitjen e kërkesës nga subjektet e përcaktuara në këtë Akt.

8. Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional, nëpërmjet njohjes së akteve dhe/ose në seancën e parë i kërkon palëve që të zgjidhin çështjen me ndërmjetësim.

9. Komisioni i Ankimit të Shërbimit Profesional zbaton procesin e rregullt ligjor dhe nxjerr aktet administrative në bazë dhe zbatim të ligjit të Kodit të Procedurave Administrative, Kodit të Procedurave (Kodit) Civil në Republikën e Shqipërisë, normave dhe referencave përkatëse të miratuara paraprakisht nga urdhri, si edhe të këtij akti.

10. Çdo Akt Administrativ (shërbimi) i Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional regjistrohet në regjistër dhe publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Urdhrit.

11. Nëse brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e aktit, i cili nuk zbatohet, atëherë bëhet kërkesa për nxjerrjen e Urdhrit Ekzekutiv nga pala përfituese ose personi fizik/juridik që kryen shërbimin ose Urdhri.

14. Aktet Administrative (shërbimi), që përfshinë zbatimin e këtij akti, të parashikuara në pikën 9 të këtij neni, përbën titull ekzekutiv.

15. Vendimet e Komisionit të Ankimit të Shërbimit Profesional të Urdhrit do të ekzekutohen nga Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. Urdhri nuk ka detyrim të parapagujë tarifën ose tarifën për shërbimin përmbarimor.

KAPITALI**Neni 33****PRONESIA E PATJETERSUESHME**

- 1) Asnjë nga anëtarët e Urdhrit nuk do të ketë kërkesë personale mbi pasurinë e Urdhrit dhe asnjë pjesë e kësaj pasurie nuk do të paguhet ose transferohet tek asnjë person i cili në çdo kohë është ose ka qenë anëtar i Urdhrit.
- 2) Shpërblimi në këmbim të çdo shërbimi të dhënë në Urdhër ose rimbursimi i shpenzimeve të njohura në mirëbesim likuidohen sipas rregullores së brendshme për veprimtarinë financiare të Urdhrit. Likuidimi i detyrimeve financiare sipas kësaj pike, nuk duhet të parandaloj/pengoj/ndaloj dhënien e shpërblimeve ose bursave për anëtarët, si edhe pagesën e interesit për paratë e huazuara nga institucioni.
- 3) Urdhri i Inxhinierive ne Republikën e Shqipërisë është pronë publike dhe e patjetërsueshme.

MIRATIMI DHE HYRJA NE FUQI**Neni 34****HYRJA NE FUQI E STATUTI**

Statuti hy ne fuqi me datën **12 MARS** **2023**

Statuti është pjese e pandashme nga akti i krijimit dhe qe është njëkohësisht i miratuar në te njëjtën kohë dhe konfirmuar nga noteri me nënshkrimin e anëtarëve themelues.

Neni 35**NDRYSHIMI I STATUTIT**

Çdo ndryshim ne Statutin e Urdhrit te Inxhinierive do te duhen te paktën 2/3 e votave te anëtarëve te Asamblesë Kombëtare.

Neni 36**REZULTATI I VOTIMIT**

VOTIMI U BE : me nënshkrim me date

MIRATOHET ME PROCESVERBALIN PERKATES

REZULTATI: **MIRATUAR ME NENSHKRIMIN E AKTIT TE KRIJIMIT**

Numri i Anëtarëve:

Prezenca:

Votues:

Votuan PO :

Votuan KUNDER :

12 MARS 2023

STATUTI

PËR TË DREJTAT THEMELORE TË BASHKIMIT TE PROFESIONISTEVE
ME TITULL 'INXHINIER' te PROFESIONEVE PERKATESE